



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
MINISTRISË SË ADMINISTRATËS PUBLIKE**

PËR VITIN 2019

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Administratës Publike në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Kreshnike Haziri, udhëheqëse ekipi, dhe Valbona Tolaj e Lumturije Sopi anëtare të ekipit, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Zukë Zuka.


TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|----|
| Përmbledhje e përgjithshme | 4 |
| Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit | 5 |
| 1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore | 6 |
| 2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli | 9 |
| 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve..... | 21 |
| Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja | 25 |
| Shtojca II: Letër konfirmimi..... | 27 |

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Administratës Publike për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore ishin përgatitur dhe menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të disa çështjeve të cilat janë paraqitur tek kategoritë përkatëse. Gjithashtu, pagesat e punonjësve pa vijueshmëri në punë, që ka ndikuar në theksim të çështjes tek opinionin e auditimit.

Ministria në përgjithësi ka të vendosura kontrolle për shpenzimin e parasë publike dhe raportim, por për një menaxhim financiar më efikas të shpenzimeve, nevojitet një monitorim i vazhdueshëm i kontrolleve në mënyrë që kontrollet të jenë më efektive në parandalimin e parregullsive.

Zbatimi i rekomandimeve nuk është i kënaqshëm, sepse nga 12 rekomandimet tona nga viti i kaluar, vetëm pesë (5) nga to ishin zbatuar dhe shtatë (7) nuk ishin adresuar ende. Rekomandimet e përsëritura përcillen me mangësi në sistemet domethënëse të ministrisë, dhe si të tilla, mbesin të pa adresuara.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht, shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dqë e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve së entitetit Ministrisë së Administratës Publike (MAP) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

1. Opinion i pamodifikuar me Theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të MAP për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Ministria. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për çështjet si në vijim:

1. Kompensimi i pagave pa vijueshmëri në punë

Sipas vendimit nr. 06/39 të datës 22.07.2015, Qeveria e Kosovës ka aprovuar konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të ashtuquajturës "Mbrojta Civile" e cila ka funksionuar në komunitatet veriore të Kosovës, si dhe mbështet zotimet e përcaktuara me këto konkluzione. Përmes këtij vendimi, obligohen ministrinë dhe agjencitë përkatëse që të bëjnë zbatimin e konkluzioneve sipas përgjegjësisë ligjore. MAP ka qenë e obliguar t'i sistemoj 20 punëtorë të komunitetit serb. Zyrtarët e lartcekur, në vitin 2019, nuk ishin paraqitur në vendin e punës, përderisa ministria kishte bërë pagesën e pagave të tyre për vitin 2019 në vlerë totale 100,582€.

Shkaku i mos paraqitjes në punë të këtyre zyrtarëve ishte mos krijimi i kushteve të duhura për punë, kontrolli i dobët dhe mos monitorimi i tyre nga menaxhmenti i ministrisë.

2. Parapagimi për shpenzimet e rrymës

Sipas LMFPP dhe rregullës 01/2013 të thesarit, shpenzimi i parasë publike nuk duhet të realizohet para pranimit të mallit/shërbimit. Ministria ka bërë pagesën për shpenzimet e rrymës në vlerë

111,501€ në muajin dhjetor, pa pranuar faturë të shpenzimit për periudhën e paguar. Pagesa është kryer duke u bazuar në faturën e muajit nëntor. Sipas ministrisë, kjo ka ndodhur me qëllim të realizimit të buxhetit dhe që shpenzimi është kalkuluar bazuar në muajin paraprak, derisa diferenca në vlerë është paguar në janar 2020.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administratës Publike është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalesjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin korrekt të menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë dhe ndihmën e ofruar gjatë procesit të auditimit.

Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi B1 ²Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mos vijimit në punë të këtyre punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e pagave të tyre të parregullta. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri rekomandohet çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të sigurohet që pagesat mos të kryhen para pranimit të shërbimit dhe faturës, të njëjtat të jenë në pajtim me LMFPP dhe rregullën 01/2013 të Thesarit për ekzekutimin e pagesave.

² Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet, si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MAP-i kishte shpenzuar 95.3% të buxhetit final për vitin 2019, duke treguar një performancë të mirë në nivel të përgjithshëm.

Ministria po bën përpjekje që t'i eliminoj dobësitë me të cilat ballafaqohet vazhdimisht për zbatimin me konsistencë të rregullave dhe obligimeve statutores, mirëpo përkundër kësaj kontrollit brenda ministrisë nuk funksionojnë në nivel të kënaqshëm dhe përshkruhen me mangësi në shpenzimin e mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale, mallra dhe shërbime si dhe në menaxhimin e pasurisë.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final ³ | 2019 Realizimi | % e Realizimit 2019 | 2018 Realizimi | 2017 Realizimi |
|---------------------------|-------------------|----------------------------|-------------------|---------------------|-------------------|-------------------|
| Burimet e Fondeve: | 28,864,620 | 31,015,873 | 29,559,141 | 95% | 20,818,378 | 19,597,632 |
| Granti i Qeverisë Buxheti | 22,902,666 | 22,834,387 | 21,779,573 | 95% | 20,797,772 | 19,580,107 |
| Të hyrat nga AKP | 5,944,348 | 8,158,335 | 7,763,354 | 95% | - | - |
| Donacionet e jashtme | 17,606 | 23,151 | 16,214 | 70% | 20,606 | 17,525 |

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,151,253€. Kjo rritje është si rezultat i vendimeve të qeverisë për pagesën e licencave të Microsoft-it.

Në vitin 2019, Ministria ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 29,559,141€, krahasuar me vitin 2018 që ishte shpenzuar 99% e buxhetit final. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2019 Realizimi | % e Realizimi mit 2019 | 2018 Realizimi | 2017 Realizimi |
|---|-------------------|-------------------|-------------------|------------------------|-------------------|-------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike: | 28,864,620 | 31,015,873 | 29,559,141 | 95% | 20,818,378 | 19,597,632 |
| Pagat dhe Mëditjet | 2,172,960 | 2,220,876 | 2,220,876 | 100% | 2,154,231 | 2,063,194 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 6,862,352 | 10,470,503 | 9,771,291 | 93% | 6,154,265 | 6,538,365 |
| Shërbimet komunale | 2,949,600 | 2,459,600 | 2,325,377 | 95% | 2,261,115 | 2,470,035 |
| Investimet Kapitale | 16,879,708 | 15,864,894 | 15,241,597 | 96% | 10,248,767 | 8,526,038 |

Shpjegimet e mëposhtme rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë bërë me vendimet e Qeverisë:

- Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar, është rritur në vlerë prej 47,916€, për pagesën e pagave të punonjësve të rekrutuar gjatë vitit dhe pas rritjes së numrit të zëvendësministrave dhe stafit të tyre përcjellës në Kabinetin e Ministrit;
- Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve kishte rritje të buxhetit final prej 3,608,151€ për pagesën e licencave të Microsoft;
- Në kategorinë e shpenzimeve komunale kishte zvogëlim të buxhetit final prej 490,000€, nga të cilat 140,000€ janë transferuar në mallra dhe shërbime; dhe
- Në kategorinë e investimeve kapitale kishte zvogëlim të buxhetit final për 1,014,814€.

2.1.1 Të hyrat

Ministria nuk planifikon të hyra të rregullta në buxhet. Megjithatë, gjatë vitit 2019 janë realizuar të hyra në vlerë 127,050€, të cilat ishin nga shitja e pasurisë sipas ankandit publik.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 2,220,876€, shumë e cila është realizuar në tërësi. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 277, derisa numri i tyre në fund të vitit ishte 272. Ne kemi testuar 21 mostra për teste substanciale në vlerë 12,839€, si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja e identifikuar për mos vijueshmërinë në punë të stafit, është trajtuar tek pjesa e opinionit si Theksim i çështjes në kapitullin 1 të këtij raporti.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë komunalitë në vitin 2019 ishte 12,691,379€, prej tyre ishin shpenzuar 11,992,166€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizim me licenca të Microsoft, shpenzimet e rrymës për 53 objektet qeveritare, furnizim me ujë për 54 institucione, furnizime me material shpenzues, shërbime kontraktuese, pajisje të TI-së, ngrohje qendrore për 17 institucione, etj. Në këtë fushë, ne kemi testuar 63 mostra për teste substanciale në vlerë 3,541,737€ si dhe 11 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2–Marrëveshjet për shërbime të veçanta më gjatë se gjashtë muaj dhe pa procedura të thjeshtëzuara të rekrutimit

Gjetja Sipas nenit 12 të Ligjit për Shërbyes civil nr.03/L-149 dhe nenit 10 të Ligjit të Punës Nr. 03/L 212, organizata buxhetore mund të angazhojnë punëtorë me afat të caktuar në bazë të kontratave “Marrëveshje për shërbime të veçanta”, për më pak se gjashtë muaj.

Ministria ka vazhduar angazhimin e punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta jo në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Ne kemi identifikuar që për punonjësit për shërbime të veçanta nuk janë zhvilluar procedura të rekrutimit me rastin e angazhimit të tyre.

Gjatë vitit 2019 të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta ishin 50 zyrtarë, ndërsa 21 prej tyre janë të angazhuar që nga viti 2017. Në disa raste ministria nuk ka zbatuar procedurën e thjeshtësuar të rekrutimit. Për të punësuarit e vitit aktual, nuk ka dëshmi për të konfirmuar se njësitë kërkuese kanë parashtruar kërkesë për nevojën e angazhimit të këtyre zyrtarëve. Angazhimi i tyre nuk ka të bëjë me ekspert të lëmisë së caktuar, por me punë në kuadër të pozitave të rregullta. Nevoja për staf shtesë dhe moskujdesi për të plotësuar vendet e lira të aprovuara me buxhet, ka shkaktuar vazhdimin e këtyre kontratave.

Ndikimi Angazhimi i nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veçanta për pozita të rregullta, pa procedura dhe në mungesë të transparencës, rritë rrezikun për plotësimin e pozitave me staf jo kompetent që nuk kanë arsimin dhe eksperiencën e duhur për të kryer punët e tyre në mënyrë cilësore.

Rekomandimi B2 Ministri duhet ndërmarrë veprime për tu siguruar se angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta / kontrata pune për detyra specifike, bëhet vetëm në rastet specifike kur ndonjë projekt apo punë e caktuar nuk mund të kryhet me stafin aktual brenda institucionit, dhe angazhimi i tyre të bëhet përmes një procesi transparent dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Çështja A2-Vonesë në mbyllje të avansit

Gjetja Sipas procedurës për regjistrim në SIMFK të avanseve për udhëtime zyrtare, përfituesi i avansit për udhëtim zyrtar obligohet që të bëjë arsyetimin e avansit, jo më larg se dy javë pas kthimit nga udhëtimi zyrtar. Ne kemi vërejtur që në fund të vitit kanë mbetur tri avanse në vlerë 484€ të pa mbyllura, dy nga të cilat kishin të bënin me kredit kartelën e ministrit dhe një avans tjetër për udhëtim zyrtar. Avanset ishin tërhequr në muajin prill, maj dhe qershor për udhëtimet në Francë, Shqipëri dhe Turqi.

Kjo ka ndodhë sipas ministrisë për shkak të modifikimit të modulit në Thesar.

Ndikimi Tejkalmi i afatit ligjor për mbylljen e avansit dhe mos arsyetimi i faturave nga shfrytëzuesit e avansit, rrisin rrezikun e mos kthimit të mjeteve tepërcë dhe shfrytëzimin e atyre mjeteve për qëllime jo zyrtare.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të vendosë kontrolle lidhur me menaxhimin e avanseve për udhëtime zyrtare, në mënyrë që secili shfrytëzues i avansit të bëjë mbylljen e tyre, siç kërkohet me procedurat e parapara me rregullat financiare.

Çështja A3-Mungesa e kërkesës për furnizime

Gjetja Sipas rregullës financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, neni 25, pika 1.1 çertifikimi i pagesës duhet të bëhet pasi të posedoj kërkesën për blerje nga njësia kërkuese. Në pagesën në vlerë prej 1,921€ për furnizim me lule në ambiente të jashtme, për Ministrinë e Mbrojtjes, nuk kemi vërejtur kërkesë për furnizim nga ministria. Komisioni pranues përbëhet vetëm nga MAP-i, duke mos u përfshirë ndonjë zyrtar i njësisë së furnizuar. Kjo ka ndodhë për shkak të kontrolleve jo adekuate dhe mbikëqyrjen e pamjaftueshme në menaxhimin e kontratës.

Ndikimi Kryerja e shërbimeve të furnizimeve pa kërkesë nga njësia e kërkuese, mund të sjellë deri te kryerja shpenzimeve të panevojshme për ministrinë.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të sigurojë që mos të bëhen furnizime dhe të mos procedohen pagesa për të cilat nuk bëhen kërkesa nga ministritë të cilat janë të parapara me kontratën për furnizime me lule për ambiente të jashtme në ndërtesa.

Çështja A4-Nënshkrimi i çertifikatës së furnizimit nga menaxheri i kontratës pas bërjes së pagesës

Gjetja Sipas rregullës financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, neni 25, pika 1.4 pagesa duhet të kryhet nëse janë zbatuar të gjitha nivelet e kontrollit të brendshëm financiar.

Me rastin e kontratës "Furnizimin me material elektrik" në vlerë 14,491€ menaxheri i kontratës ka bërë çertifikimin e pagesës me datë 13.09.2019, ndërsa pagesa ishte ekzekutuar me datë 26.08.2019. Po ashtu, kjo çështje, nuk është vërejtur edhe në nivelet tjera të procesimit të pagesës.

Sipas ministrisë kjo ka ndodhë për shkak të gabimit teknik, megjithatë, vërehet se niveli i kontrollit gjatë procesimit të pagesës është përcjellë me pa siguri.

Ndikimi Kryerja e pagesave të cilat nuk kanë dokumentacionin e kompletuar, mund të rezultojë në mos zbatimin e kontratave sipas kushteve të kontraktuara.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj që me rastin e pagesës së shpenzimeve, menaxheri i kontratës dhe çertifikuesi të aplikojnë kontrolle efektive në procesin shpenzimit të parasë publike për t'u siguruar se pagesat bëhen vetëm për furnizimet e realizuara në kohë dhe sipas cilësisë së përcaktuar me kontratë.

2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 15,864,894€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 15,241,597€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e ndërtesave arsimore, objekte administrative dhe pajisje të teknologjisë informative (softuer dhe harduer), etj. Ne kemi testuar 95 mostra për teste substanciale në vlerë 10,055,501€, si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B3 - Klasifikimi i shpenzimeve në kategori jo adekuate

Gjetja Sipas Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 06-L-133 menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë definohet që shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike. Me rastin e analizës së pagesave sipas kodeve ekonomike, ne kemi gjetur se pagesat nuk janë bërë nga kodet adekuate. Pagesat kanë rezultuar me gabime për shkak të klasifikimit të gabuar qysh në fazën e aprovimit të Ligjit për ndarjet buxhetore dhe pagesës direkte nga vendimet gjyqësore.

Nga kategoria e investimeve kapitale keq klasifikimi arrin vlerën 438,984€, prej tyre për “Platformën e interoperabilitetit” janë shpenzuar 124,344€, për “Mbështetjen për zbatimin e reformës së administratës publike” janë shpenzuar 314,640€ të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë për mallra dhe shërbime.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoria e gabuar mund të rezultojnë me pasqyrim çorientues të shpenzimeve, duke nënvlerësuar një kategori dhe mbivlerësuar kategorinë tjetër të shpenzimeve, që për efekt kanë paraqitjen e pa saktë të gjendjes së llogarive.

Rekomandimi B3 Ministri, duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore) dhe që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.

Çështja A5- Nënshkrimi i kontratave për ndërtim pa aplikim paraprak për leje ndërtimore

Gjetja Sipas Rregullës së udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, neni 20. Specifikimet Teknike , pika 20.10- për kontratat e punës duhet të përgatiten në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin specifik që është në fuqi në Kosovë si dhe në raste kur kërkohet, rregullave të përcaktuara në certifikatat administrative dhe lejet e nevojshme për punimet që do të ekzekutohen. Sipas Ligjit për ndërtim Nr. 04/L-110 , Neni 20 kërkesa për lëshimin e lejes ndërtimore, pika 3, kërkesës së leje ndërtimore i bashkangjitet kopja e planit dhe certifikata e pronësisë të aplikuesit, siç është certifikuar nga organet kompetente.

Te projekti “Ndërtimi i objektit të Universitetit të Mitrovicës-Faza e III -të”, në vlerë 7,297,020€, kontrata është nënshkruar me 22.04.2016. Mirëpo për shkaqe të punëve shtesë (aneksi për amfiteatër) afati për kryerjen e punëve ishte zgjatur edhe për 75 ditë pune përmes dy aneks kontratave, për arsye se MAP ka zhvilluar procedurat e prokurimit dhe ka nënshkruar kontratë në mungesë të kompletimit të dokumentacionit (pa marrë pëlqimin e lokacionit nga autoritetet komunale përkatëse). Kjo ka ndodhur pasi që vendi ku duhej të ndërtohej amfiteatri, një pjesë e parcelës së tokës ishte parcelë e komunës së Mitrovicës dhe pjesa tjetër në pronësi të MMPH-së. Si rezultat i këtyre pengesave, MAP-it i është lejuar ndërtimi i objektit të amfiteatrit tek më 19.02.2020. Menaxherja e projektit ka dhënë rekomandim pas marrjes së lejes për amfiteatrin që të punohet një plan i ri dinamik për të cilin ka rekomanduar që të bëhet aneks kontratë dhe shtyrje e afatit kohor.

Tek projekti "Impianti për trajtimin e ujërave të zeza" (IUTZ) në vlerë 599,304€, i nënshkruar me datë 13.09.2019, plani dinamik sipas Kushteve të Veçanta të Kontratës, duhej të përfundonte 36 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës, përderisa sipas planit për menaxhimin e kontratës, llogaritja e ditëve të punës do të bëhet me rastin e sigurimit të lejes ndërtimore. Mos posedimi i lejes ndërtimore ka pamundësuar fillimin e punimeve menjëherë pas nënshkrimit të kontratës. MAP ka aplikuar për leje ndërtimore më 29.10.2019, ndërsa vendimi nga Komuna e Prishtinës për lejimin e zhvillimit të punëve ishte lëshuar më 23.12.2019. Për projektin në fjalë, më datë 20.09.2019, është paguar në formë të avancit shuma prej 89,895€ sipas kushteve të kontratës.

Sipas MAP arsyeja e mos përfundimit të punëve ishte mos projektimi fillestar në përputhje me nevojat reale të MAP-it. Kjo kishte ndodhë për arsye se MASHT dhe MAP kanë nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi në vitet e mëhershme për bartjen e fondeve dhe projekteve kapitale për ndërtimin dhe renovimin e objekteve të ndryshme (arsimore dhe aftësuese). Me këtë rast MAP kishte kompetencë vetëm për menaxhimin e ndërtimit të objekteve dhe udhëheqjen e procedurave tenderuese.

Ndikimi

Mungesa e planifikimit të duhur për projektet ndërtimore, rritë rrezikun që projektet të kenë nevojë për mjete financiare shtesë si dhe të mos realizohen sipas planit të paraparë. Vonesat në implementimin e projekteve kapitale kanë ndikim në dinamikë të punimeve dhe shtyerjen e afateve për dhënien në përdorim të këtyre objekteve.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të siguroj që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për projekte të reja ndërtimore, t'i kushtohet vëmendje e shtuar specifikimit të kërkesave dhe planifikimi i objekteve të bëhet duke pasur parasysh të gjitha elementet që e përbëjnë objektin si tërësi funksionale. Kjo do të ndihmonte, që të mos ketë vonesa në implementimin e projekteve si dhe të mos shfaqet nevoja për mjete financiare shtesë.

2.1.5 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B4- Shpenzime shtesë nga pagesat me vendime gjyqësore

Gjetja Sipas dispozitave ligjore të nenit 39, paragrafi 1, të LMFPP, obligim i vonuar për pagesë i organizatës buxhetore konsiderohet fatura e cila nuk është paguar 30 ditë pas pranimit nga ana e organizatës.

Nga kategoria e investimeve kapitale duke u bazuar në urdhrin përmbartimor për ekzekutim nr. 440/19 të datës 20.06.2019, Thesari ka ekzekutuar pagesën në vlerë 1,273,660€ (vlera e gjobës 936,700€ dhe vlera për kamatë dhe shpenzime përmbartimore 336,960€). Pagesa është kryer nga projekti kapital "Ndërtimi i objektit të ATK-së".

Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë kryer tri (3) pagesa në vlerë të 5,491€ me vendime gjyqësore. Këto pagesa kanë rezultuar edhe me shpenzime shtesë të gjykatës, për shkak të mos ekzekutimit me kohë të këtyre pagesave. Nga kjo pagesë shuma prej 3,994€ është paguar për kamatë ligjore, shpenzime të procedurës dhe për kompensim të zyrës përmbartimore.

Kjo ka ndodhur për shkak që Ministria ka refuzuar njohjen e pagesës duke aluduar që nuk qëndron pretendimi i debitorit lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike në mungesë të dëshmisë për kryerjen e punëve shtesë.

Ndikimi Ekzekutimi i pagesave të tilla ndikojnë në implikime buxhetore dhe rrisin rrezikun që projektet fillestare të mos realizohen, duke kryer obligimet përmes pagesave direkte apo procedurave të përmbartimit jashtë shpenzimeve të planifikuara.

Rekomandimi B4 Ministri të siguroj se obligimet e papaguara duhet të trajtohen me prioritet me rastin e planifikimeve buxhetore, si dhe të forcoj disiplinën financiare dhe të paguaj me kohë të gjitha obligimet.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale ishte 51,397,102€, pasurive jokapitale 304,250€, si dhe e stoqeve 537,111€. Ne kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 12,120,880€, si dhe katër (4) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A6 - Mangësi në raportin e inventarizimit

Gjetja Rregullorja Nr. 02/2013 neni 4.7, parasheh hartimin e raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Raporti i inventarizimit duhet të përmbajë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe shqyrtimin e diferencave në mes gjendjes kontabël dhe dëmtimeve të konstatuara. Sipas Nenit 19, Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare do të jetë organ i përkohshëm i formuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ.

Raporti i inventarizimit nuk është përfunduar me kohë, mungonte vlera e pajisjeve duke bërë që PVF-të mos të kenë vlerë reale të stoqeve. Kjo ka ndodhë për shkak të mos funksionimit të sistemit e-pasuria dhe mos ndërmarrjes së veprimeve të duhura për përmirësimin e menaxhimit të tyre.

Ndikimi Mos azhurnimi i regjistrit të pasurisë, tjetërsimi dhe evidentimi i tyre, rrisin rrezikun që ministria mos të ketë kontroll mbi gjendjen aktuale të pasurive, dhe pasuritë të keqpërdorën apo humben, si dhe në PVF të pasqyrohen në vlera joreale (të mbivlerësohen apo të nënvlerësohen). Kjo pamundëson menaxhimin efektiv dhe kontrollin mbi pasuritë.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të siguroj që anëtarët e komisionit për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë të emërohen nëpunës kompetent dhe profesional që do të mundësonin inventarizimin e plotë, në pajtim me kërkesat ligjore dhe prezantimin e saktë të pasurisë në PVF.

2.3 Detyrimet

2.3.1 Detyrimet e papaguara

Sipas PVF, pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 2,653€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

Çështja B5 – Vonesa në pagesën e obligimeve

Gjetja

Sipas LMFPP, nenit 39 kërkohet që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet, shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Nga mallrat e shërbimet është paguar fatura për shfrytëzimin e frekuencave për nevoja të rrjetit shtetëror të Kosovës nga ARKEP në vlerë 173,290€, e cila i përkiste periudhave paraprake 2010-2019. Këto shpenzime/obligime nuk ishin raportuar si të tilla, për shkak të refuzimit të njohjes së shpenzimeve nga Ministria.

Gjithashtu, një mostër e përzgjedhur e cila ishte paraqitur si obligim i papaguar në PVF në vlerë 502€, nuk është paguar ende as gjatë periudhës së auditimit (qershor 2020), duke kaluar afatin ligjor për pagesë të faturës. Kjo pagesë nuk është realizuar për shkak të mos dhënies prioritet të faturave të mbetura nga muajt paraprak.

Arsyeja e mos pagesës nga ARKEP është për shkak që shfrytëzimi i frekuencave bëhet për nevoja të rrjetit shtetëror të Kosovës dhe MAP nuk e ka njohur si borxh dhe vazhdimisht ka kërkuar të lirohet nga pagesa dhe të mos faturohet.

Ndikimi

Mos pagesa e obligimeve brenda afatit ligjor mundësinë që furnitorët t'i drejtohen përmbauesve dhe gjykatave të cilat krijojnë shpenzime shtesë për buxhetin e ministrisë. Në anën tjetër, mos raportimi i obligimeve të mbetura, nuk jep pasqyrim të drejtë të obligimeve në PVF.

Rekomandimi B5 Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit (përveç atyre që kanë afat) të evitohet. Po ashtu, të ketë raportim të drejtë të obligimeve në raportimet financiare.

2.3.2 Detyrimet kontingjente

Vlera e detyrimeve kontingjente në PVF-të e vitit 2019 ishte 3,713,074€ të cilat kanë të bëjnë me paditë e bëra ndaj ministrisë për pagesat të cilat i ka kontestuar ministria dhe të njëjtat janë në procese gjyqësore.

Gjatë testimit tonë është identifikuar:

Çështja B6 – Niveli i lartë i detyrimeve kontingjente

- Gjetja** Neni 46, pika b. e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) përcakton një vlerësim të të gjitha detyrimeve kontingjente, duke përfshirë një vlerësim të riskut të tyre. Gjatë vitit 2019 ministria në PVF kishte deklaruar detyrime kontingjente 3,713,074€, ndërkaq sipas regjistrave të siguruar nga zyra ligjore janë 3,957,585€. Ministria nuk ka të hartuar ndonjë politikë apo strategji për vlerësimin e rrezikut të këtyre detyrimeve. Kjo ka ndodhur nga pakujdesia e menaxhmentit për të ndërmarrë veprime lidhur me menaxhimin efikas të detyrimeve kontingjente.
- Ndikimi** Mungesa e vlerësimit të rrezikut për trajtimin e detyrimeve kontingjente, rritë mundësinë e shndërrimit të tyre në obligime faktike që do të shkaktonte vështirësi buxhetore në nivele të aktiviteteve dhe projekteve për ministrinë.
- Rekomandimi B6** Ministri duhet të siguroj që për detyrimet kontingjente të bëhet një vlerësim i rrezikut me qëllim të planifikimit më të mirë financiar dhe daljes së mundshme të parasë gjatë vitit buxhetor, në mënyrë që të mos rrezikohen aktivitetet e përditshme të ministrisë nga aktgjykimet e papritura gjyqësore.

2.3.3 Detyrimet kontraktuale

Vlera e detyrimeve kontraktuale në MAP në fund të vitit 2019 është 39,279,733€. Këto detyrime kanë të bëjnë me kontrata të cilat kanë qenë të buxhetuara dhe të lidhura me afat më të gjatë se një vit (kontrata kornizë) dhe për të cilat obligimet barten për pagesë në vitet e ardhshme me rastin e ndodhjes së furnizimeve apo shërbimeve.

2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) funksionon me dy anëtarë të stafit, drejtori dhe një auditor. Sipas drejtorit të auditimit, kjo strukturë me këtë përbërje konsiderohet e mjaftueshme për përmbushjen e objektivave dhe planifikimit të auditimit për vitin pasues.

Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. NjAB ka përgatitur planin vjetor të auditimit dhe planin strategjik 2019-2021. Fokus i auditimit ishte viti 2019. Për vitin 2019 janë planifikuar dhe realizuar shtatë (7) raporte të auditimit. Fushat kryesore të mbuluara për auditim gjatë këtij viti ishin: menaxhimi i automjeteve, menaxhimi i pasurisë, prokurimi, menaxhimi i buxhetit dhe i shpenzimeve.

MAP ka të themeluar komitetin e auditimit dhe janë mbajtur katër takime pune gjatë vitit 2019.

Çështja A7 - Zbatim i ulët i rekomandimeve të auditimit të brendshëm

- Gjetja** Sipas Ligjit për Kontrollit e Brendshëm të Financave Publike, Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA), ndër të tjera, duhet të ndërmerr veprime për përmirësimin e sistemeve në pajtim me rekomandimet e auditimit të brendshëm. Gjatë vitit 2019 janë dhënë 38 rekomandime dhe vetëm 15 nga to ishin zbatuar, 10 ishin në proces dhe 13 nuk ishin adresuar fare. Arsyeja e mos zbatimit të rekomandimeve në nivelin e duhur është për shkak se nuk kishte monitorim formal të rekomandimeve nga ana e menaxhmentit.
- Ndikimi** Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të NjAB-së, rritë rrezikun e përsëritjes së gabimeve dhe mangësive të identifikuara në funksionimin e kontrolleve të brendshme.
- Rekomandimi A7** Ministri duhet të rritë përgjegjësinë në të gjitha nivelet menaxhuese të ministrisë që rekomandimet e dala nga auditimi të trajtohen me kujdesin maksimal.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e Ministrinë e Administratës Publike për vitin 2018 ka rezultuar në 12 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

MAP ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve deri më 30 shtator, mirëpo jo edhe deri me 15 mars sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit për vitin 2019, pesë (5) rekomandime janë zbatuar dhe shtatë (7) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

| Nr. | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2018 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|-----|-------------------|---|--|-------------------------|
| 1 | PFV | Rekomandimi A1 Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mos vijimit në punë të këtyre punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e parregullta për pagat e tyre dhe për qiranë e objekteve për zyre. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, Ministri rekomandohet çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri. | Nuk janë ndërmarra veprime. | Rekomandim i pa zbatuar |
| 2 | PVF | Rekomandimi B1 Ministri duhet të siguroj se do të rritet kujdesi gjatë hartimit të buxhetit duke i klasifikuar drejt shpenzimet sipas planit kontabël i aprovuar nga ana e Thesarit-MF dhe udhëzimit administrativ 05/2018 për klasifikimin ekonomik të shpenzimeve. | Nuk janë ndërmarra veprime. | Rekomandim i pa zbatuar |
| 3 | PFV | Rekomandimi A2 Ministri duhet të siguroj funksionimin adekuat dhe sistematik të kontrollit lidhur me plotësinë e regjistrave të pasurisë dhe se Pasqyrat Financiare Vjetore do t'i nënshtrohen rishikimit dhe vlerësimit rigoroz nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, para se deklarata të nënshkruhet dhe PFV të dorëzohen në Ministrinë e Financave. | Janë ndërmarra veprimet e duhura për plotësimin e regjistrave të pasurisë. | Rekomandim i zbatuar |

| | | | | |
|----|---------------------|--|--|-------------------------|
| 4 | Mallra dhe shërbime | Rekomandimi A3 Ministri duhet ndërmarrë veprime për tu siguruar se angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta /Kontrata pune për detyra specifike, bëhet vetëm në rastet specifike kur ndonjë projekt apo punë e caktuar nuk mund të kryhet me stafin aktual brenda institucionit, dhe angazhimi i tyre të bëhet përmes një procesi transparent dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Rekomandim i pa zbatuar |
| 5 | Mallra dhe shërbime | Rekomandimi B2 Ministri të siguroj se obligimet e papaguara duhet të trajtohet me prioritet me rastin e planifikimeve buxhetore, si dhe të forcoj disiplinën financiare dhe të paguaj me kohë të gjitha faturat. Ky rekomandim në vitin 2019 është bartë te nënkapitulli i obligimeve. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Rekomandim i pa zbatuar |
| 6 | Investime kapitale | Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj që për të gjitha projektet kapitale të bëjë planifikimin e duhur për të gjitha vitet dhe çdo kontratë të ketë buxhet të mjaftueshëm mbi shpenzimin e kontraktuar. | Menaxhment i është siguruar që të ketë buxhet të mjaftueshëm para lidhjes së kontratave. | Rekomandim i zbatuar |
| 7 | Investime kapitale | Rekomandimi A5 Ministri duhet të rrisë kontrollet në menaxhimin e shpenzimeve për projekte kapitale dhe të siguroj se paradhëniet do të ndodhin me arsyeshmëri të duhur sipas kërkesave kontraktuale. | Kontratat janë nënshkruar në pajtim me ndarjet buxhetore. | Rekomandim i zbatuar |
| 8 | Investime kapitale | Rekomandimi C1 Ministri duhet të forcoj masat e përgjegjësisë dhe llogaridhënies të zyrtarëve përgjegjës me rastin e aprovimit të kërkesave për pagesat e paradhënies. | Paradhëniet nuk e kanë tejkaluar vlerën e lejuar me ligj të buxhetit. | Rekomandim i zbatuar |
| 9 | Pasuritë | Rekomandimi B3 Ministri duhet të qartësoj kërkesat rregullative, të nxjerrë udhëzim të brendshëm lidhur me inventarizimin e pasurisë jo financiare dhe të trajtoj stafin relevant. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Rekomandim i pa zbatuar |
| 10 | Obligime | Rekomandimi B4 Ministri duhet të siguroj se shpenzimet e buxhetit i përmbahen kufijve buxhetor dhe mbi këtë bazë të bëhet planifikimi i buxhetit dhe plani i rrjedhës së parasë të ju përgjigjet nevojave reale të ministrisë. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Rekomandim i pa zbatuar |

| | | | | |
|----|-----------------------|---|--------------------------------|-------------------------|
| 11 | Detyrime Kontingjente | Rekomandimi B5 Ministri duhet të siguroj që për detyrimet kontingjente të bëhet një vlerësim i rrezikut me qëllim të planifikimit më të mirë financiar, të analizojë shkaqet e ndodhjes se tyre me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Rekomandim i pa zbatuar |
| 12 | NJAB | Rekomandimi C2 Ministri duhet të siguroj që fushëveprimi i auditimit të jetë për vitin aktual me qëllim që eliminimi i mangësive në sisteme të bëhet me kohë, e jo pasi që ngjarjet të kenë përfunduar, të ndërmerr masa që rekomandimet e dhëna nga NJAB të adresohen dhe komitetin e auditimit të mbaj përgjegjës për rolin mbikëqyrës. | Fokusi i AB ishte viti aktual. | Rekomandim i zbatuar |
| Nr | Fusha e auditimit | Rekomandimet e vitit 2019 | | |
| 1 | PFV | Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mos vijimit në punë të këtyre punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e pagave të tyre të parregullta. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri rekomandohet çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri. | | |
| 2 | PVF | Ministri duhet të sigurohet që pagesat mos të kryhen para pranimit të shërbimit dhe faturës, të njëjtat të jenë në pajtim me LMFPP dhe rregullën 01/2013 të Thesarit për ekzekutimin e pagesave. | | |
| 3 | Mallrat dhe shërbimet | Ministri duhet ndërmarrë veprime për tu siguruar se angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta /kontrata pune për detyra specifike, bëhet vetëm në rastet specifike kur ndonjë projekt apo punë e caktuar nuk mund të kryhet me stafin aktual brenda institucionit, dhe angazhimi i tyre të bëhet përmes një procesi transparent dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. | | |
| 4 | Mallrat dhe shërbimet | Ministri duhet të vendosë kontrolle rigorozë tek menaxhimi i avanseve për udhëtime zyrtare, në mënyrë që secili shfrytëzuesi i avansit të bëjë mbylljen e tyre, siç kërkohet me procedurat e parapara me rregullat financiare. | | |
| 5 | Mallrat dhe shërbimet | Ministri duhet të sigurojë që të forcohen kontrollet e brendshme, në mënyrë që në të ardhmen mos të bëhen furnizime dhe të mos të procedohen pagesa për të cilat nuk bëhen kërkesa nga ministritë të cilat janë të parapara me kontratën për furnizime me lule për ambiente të jashtme në ndërtesa. | | |

| | | |
|----|--|---|
| 6 | Mallrat dhe shërbimet | Ministri duhet të siguroj që me rastin e pagesës së shpenzimeve menaxheri i kontratës dhe certifikuesi të aplikojnë kontrolle efektive në procesin shpenzimit të parasë publike për t'u siguruar se pagesat bëhen vetëm për furnizimet e realizuara në kohë dhe sipas cilësisë së përcaktuar me kontratë. |
| 7 | Investime Kapitale | Ministri, duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore) dhe që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate. |
| 8 | Investime Kapitale | Ministri duhet të sigurojë që me rastin e inicimit të procedurave për projekte të reja ndërtimore, ti kushtohet vëmendje e shtuar specifikimit të kërkesave dhe planifikimi i objekteve të bëhet duke pasur parasysh të gjitha elementet që e përbëjnë objektin si tërësi funksionale. Kjo do të ndihmonte, që të mos ketë vonesa në implementimin e projekteve si dhe të mos shfaqet nevoja për mjete financiare shtesë. |
| 9 | Çështjet e përbashkëta mallra dhe shërbime, investime kapitale | Ministri të siguroj se obligimet e papaguara duhet të trajtohen me prioritet me rastin e planifikimeve buxhetore, si dhe të forcoj disiplinën financiare dhe të paguaj me kohë të gjitha obligimet. |
| 10 | Pasuritë | Ministri duhet të siguroj që anëtarët e komisionit për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë të emërohen nëpunës kompetent dhe profesional që do të mundësonin inventarizimin e plotë, në pajtim me kërkesat ligjore dhe prezantimin e saktë të pasurisë në PVF. |
| 11 | Obligimet e papaguara | Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit (përveç atyre që kanë afat) të evitohet. Po ashtu, të ketë raportim të drejtë të obligimeve në raportimet financiare. |
| 12 | Detyrimet kontigjente | Ministri duhet të siguroj që për detyrimet kontingjente të bëhet një vlerësim i rrezikut me qëllim të planifikimit më të mirë financiar dhe daljes së mundshme të parasë gjatë vitit buxhetor, në mënyrë që të mos rrezikohen aktivitetet e përditshme të ministrisë nga aktgjykimet e papritura gjyqësore. |
| 13 | Auditimi i brendshëm | Ministri duhet të rritë përgjegjësinë në të gjitha nivelet menaxhuese të ministrisë që rekomandimet e dala nga auditimi të trajtohen me kujdesin maksimal. |

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit


157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA/
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të **Ministrit së Administratës Publike** për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Agim Veliu

Ministër i Punëve të Brendshme



16 korrik 2020, Prishtinë

Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr. "Luan Haradinaj" Objekti i MPB-së kati i I-ë - 10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 200 19 005
<http://www.mpb-ks.org>